



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:026669

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05708972

KPPP.nr. 154/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Banka për Biznes” me seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti” Nr,128, ndaj debitorëve 1. “Tonex” SH.P.K., me numër të biznesit 810159089, me adresë rr. “Ramiz Cernica” p.n. Gjilan, 2. “Peps FOOD” me numër biznesi 810002585, me adresë rr. “Marie Shllaku” p.n. Gjilan, 3. D.M. me numër personal ... me adresë banimi rr.”Hamdi Pograxha” Gjilan, 4. V.L.M. me numër personal ... me adresë banimi rr.”Hamdi Pograxha” Gjilan, 5. B.A. me numër personal ... me adresë banimi rr. “Muharrem Kurtishi” p.n. Gjilan, duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.516/2023 të datës 14.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seance, me datë 20.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorëve Tonex” SH.P.K., “Peps FOOD”, D.M., V.L.M. dhe B.A., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 516/2023 të datës 14.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr. 516/2023 i datës 14.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat, Fadil I. Hoxha.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të “Banka për Biznes” ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 516/2023 të datës 14.12.2023, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues Kontratë për Kredi të biznesit Nr.K022111/908 aneks kontrata (shtojca), Kontratë për Kredi të biznesit Nr.K0220/895 aneks kontrata (shtojca) dhe Kontratë për mbitërheqje Nr.K0221/800 aneks kontrata (shtojca) si dhe Shtojca Nr.1. Kontratës së kolateralit

– K0221/908 e datës 22.11.2021 dhe Konfirmimit të regjistrimit R-20211125-668, Konfirmimit R-20211102-530 dhe Konfirmimit R-20201001-283, lidhur me pasurinë e lënë peng dhe atë, Pajisje të biznesit: “Tonex” SH.P.K., sipas listës të datës 30.09.2021 me nr. serik 30092021 në vlerë prej 82.200.00€, “Peps FOOD”, sipas listës të datës 30.09.2021 me nr. serik 30092021 në vlerë prej 31,890.00€, specifikacionit të mallit të datës 14.09.2021 në vlerë prej 10,034.00€, specifikacionit të mallit të datës 14.09.2021 në vlerë prej 250.00€, veturë e tipit “Mercedes Benz” 320 CDI 4 MATIC, me targa ... i vlerësuar 9,000.00€, veturë e tipit “Reisch RHS” me targa ... i vlerësuar 6,000.00€, veturë e tipit “Opell Combo” Pikap, me targa ... i vlerësuar 2,100.00€, veturë e tipit “Volksëagen VË” Caddy, me targa ... i vlerësuar 3,000.00€, veturë e tipit “Scania” A4X2 124L 420, me targa vlerësuar 7,200.00€, veturë e tipit “BMË” X5 Drive, me targa vlerësuar 12,600.00€, veturë e tipit “Citroen” me targa vlerësuar 1,800.00€, veturë e tipit “Renault” Kango Express, me targa vlerësuar 3,600.00€, veturë e tipit “Volksëagen” VË Golf me targa vlerësuar 3,600.00€, veturë e tipit “Trailor” gjysmë rimorkio, me targa vlerësuar 3,000.00€, veturë e tipit “DAIMLER BENZ”, me targa ... vlerësuar 6,000.00€, veturë e tipit “Soda”, me targa vlerësuar 2,700.00€, veturë e tipit “Mercedes”, me targa ... vlerësuar 12,300.00€, pajisje të ndryshme të biznesit “Tonex” SH.P.K., sipas listës së datës 31.08.2020 në vlerë prej 92,400.00€, pajisje të ndryshme të biznesit “Peps FOOD” SH.P.K., sipas listës të datës 31.08.2020 në vlerë prej 15,355.00 Euro; pajisje të datës 30.09.2021 në vlerë prej 21,741.00€, makinë për paketim profi line me nr. serik KD 99B prodhuesi “Braund” e vlerësuar 15,000.00€ si dhe të gjitha llogarit bankare të tashme dhe në të ardhmen për personat e lidhur me këtë kredi, kamata e rregullt dhe kamatëvonesa që do të arrij deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore të gjithë këtë në afat prej 7 ditësh, përmes bllokimit të gjitha llogarive në të gjitha bankat komerciale apo përmes sekuestrimit dhe shitjes së kolateralit, duke obliguar debitorët që në afat prej 7 ditësh të paguajnë shumën prej 93,626.18€, me kamatë vjetore deri në përmbylljen e borxhit në tërësi.

Debitorët brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, kanë paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit me pretendimin se lartësia e borxhit të kërkuar nuk përputhet me lartësinë reale duke llogaritur edhe pagesat e vazhdueshme të kredisë nga ana e debitorëve. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, të caktoj ekspertizë financiare për llogaritjen e lartësisë së mbetur të kredisë si dhe të shlyej kumatën ndëshkuese pasi që e njëjta është e palejuar.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorëve si të pabazuara, pasi që të njëjtat nuk janë mbështetur me asnjë provë të vetme duke e cilësuar kështu prapësimin në kundërshtim me dispozita ligjore të LPP-së. Tutje ka theksuar se propozimi për përmbarrim i plotëson të gjitha kushtet ligjore pasi që i njëjti është iniciuar në bazë të dokumentit përmbarrimorë dhe në të janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara me këtë ligj. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsytet si në vijim:

Gjykata gjeti se procedura përmbarrimore është iniciuar në bazë të dokumentit përmbarrimor Kontratë për Kredi të biznesit Nr.K022111/908 aneks kontrata (shtojca), Kontratë për Kredi të biznesit Nr.K0220/895 aneks kontrata (shtojca) dhe Kontratë për mbitërheqje Nr.K0221/800 aneks kontrata (shtojca) si dhe Shtojca Nr.1. Kontratës së kolateralit – K0221/908 e datës 22.11.2021 dhe Konfirmimit të regjistrimit R-20211125-668, Konfirmimit R-20211102-530 dhe Konfirmimit R-20201001-283,

Gjykata gjen se Urdhri Përmbarrimor P.nr. 516/2023 i datës 14.12.2023 i lejuar nga Përmbarruesi Privat, Fadil I. Hoxha, është nxjerr në përputhje me dispozitat ligjore, kjo për faktin se i njëjti bazohet në dokumente përmbarrimore të cilat janë në përputhje me nenin 21 i LPP-së i cili ka përcaktuar se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*, janë dokumente përmbarrimore, po ashtu neni 36 i LPP-së parasheh se: *“1. Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente përmbarruese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, pasi që Kontrata për Kredi të biznesit Nr.K022111/908 aneks kontrata (shtojca), Kontrata për Kredi të biznesit Nr.K0220/895 aneks kontrata (shtojca) dhe Kontrata për mbitërheqje Nr.K0221/800 aneks kontrata (shtojca) si

dhe Shtojca Nr.1. Kontratës së kolateralit – K0221/908 e datës 22.11.2021, janë paraqitur në kopje të noterizuara pranë zyrës noteriale të noterit Arbena H. Shehu, të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, si dhe në përputhje me nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i cili përcakton se: “2. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.”, në shkresa të lëndës janë bashkangjitur edhe Konfirmimi i regjistrimit R-20211125-668, Konfirmimi R-20211102-530 dhe Konfirmimi R-20201001-283, me të cilat dëshmohet regjistrimi i pengut në regjistrin zyrtarë të pengut.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.154/24, datë 20.05.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.